

SHKALLËT E BESIMTARËVE NË RRUGËTIMIN DREJT ALLAHUT (MEDAARIXH ES-SAALIKIIN)

Psherëtima / es-Nefesu / النَّفْسُ

Dr. Hatim el-Haxh

Materiali është përmbledhje e kuptimeve të audio-ligjëratës nga nxënësit e hoxhës

<https://buff.ly/2hbVv4T>

Allahu ﷻ tha:

"فَلَمَّا أَفَاقَ قَالَ سُبْحَانَكَ"

"Kur ai mori veten, tha: 'I patëmeta je Ti!'"¹ (el-A'raaf, 43)

Nefes (psherëtima)² quhet *nefes*, sepse ai që psherëtin, gjen rehati në këtë.³ Kjo ka tri nivele të cilat u ngjajnë niveleve të shkallës së saktësisë (*wakt*).⁴ Ka tri psherëtima (shpirtërore):

Psherëtima e parë është një psherëtimë e lëshuar gjatë mbulimit.⁵ Kjo është përplot trazime dhe shoqërohet me dije.⁶ Kur personi psherëtin, e bën këtë me dëshpërim; kur flet, e bën këtë me pikëllim. Mua më duket se kjo del nga

¹ Kjo shkallë ka të bëjë me një psherëtimë (shpirtërore) që personi lëshon ose kur çlirohet nga një ankth, ose kur është duke kaluar mes dy stacioneve, ose kur ndien lehtësim, ose kur ndien gëzim. Ajeti flet për lehtësimin dhe qetësimin e pejgamberit Musa pasi atij i ra të fikët, kur Zoti nisi t'i shfaqej malit.

² Mund të përkthehet edhe si frymë ose pushim i shkurtër.

³ Rrënja e kësaj fjale, që ka tri shkronja (n-f-s), zakonisht nënkupton qetësim pas shqetësimit.

⁴ Ngjashmëria e përgjithshme mes psherëtimës dhe saktësisë/çastit (*wakt*) është se kohët tona maten me frymë. Ngjashmëria specifike është se të dyja janë të varura nga gjendjet e brendshme kalimtare (*haal*).

⁵ Ai ka qenë në një gjendje (*haal*) ose në një pozitë (*mekaam*) e cila ka qenë e fshehur nga ai, kështu që ai tash vuan dhimbjen e humbjes.

⁶ Ai ka dijen që e bën ta vajtojë humbjen, por jo dhe ëmbëlsinë që do t'i jepte një pushim të shkurtër (nga humbja).

vetmia e mbulimit. Kjo është errësira që konsiderohet të jetë një shkallë (stacion).⁷

Psherëtima e dytë është një psherëtimë e lëshuar gjatë të parit e paraqitjes hyjnore⁸, dhe kjo është një psherëtimë që:

- Gjendet në shkallën e lumturisë në pritje të çlirimit nga të parët⁹
- Është përplot me dritë të realitetit (*wuxhuud*)¹⁰
- Dhe pret ndërprerjen e të gjitha sinjaleve.¹¹

Psherëtima e tretë është një psherëtimë:

- E pastruar me ujin e shenjtërisë¹²
- Që qëndron nëpërmjet planit të para-përjetësisë¹³
- Dhe është një psherëtimë që quhet drita e pastër.

Kështu, psherëtima e parë është një llambë për të zellshmin, e dyta është një shkallë për ndjekësin e shtegut, dhe e treta është një kurorë e arritësit.

⁷ Shejhu (el-Harawi) nuk duket ta konsiderojë këtë si privim nga një shkallë (stacion). Ata nga Mjeshtërit e shtegut (të pastrimit shpirtëror) që e konsideronin këtë si privim, mund të kenë menduar – siç sqaron Ibn el-Kajjim në *el-Medaarixh* – se kjo vjen me dobi të shumta, ndër to: e bë robin të mos nënçmojë dhuratat e Tij, e bën robin të mbështetet vetëm në Të, jo në dijen ose gjendjen (*haal*) e tij; e bën robin të shijojë hidhësinë e privimit, në mënyrë që më vonë të jetë mirënjohës për ëmbëlsinë e hirit të Tij.

⁸ Kjo është shfaqja e manifestimeve të cilësive hyjnore para syve të zemrës.

⁹ Kjo ende është të parët e hyjnores me sytë e zemrës. Shfaqja e cilësive të Tij para zemrës nuk është e tëra e barabartë. Të parët me sy është faza kur shfaqja e cilësive të Tij plotësohet.

¹⁰ Realiteti (*wuxhuud*) është shkalla e 96-të e këtij libri.

¹¹ Për shejhun (el-Harawi) ndërprerja e sinjaleve ndodh në pikën e vetasgjësimit, ku thëniet e madje dhe sinjalet s'mund të përshkruajnë përjetimin.

¹² Të pastruar sa të mos shohin gjë tjetër (*siwaa*) veç Zotit.

¹³ Kjo zemër ka lënë mbrapa çdo gjë të krijuar (*muhdeth*) dhe është kapur vetëm për para-përjetësinë.